

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses S. M. – B., nga ..., të cilin e përfaqëson me autorizim N. M., avokat nga ..., kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve "S." në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson K. P., dhe Kompania e Sigurimeve "I.", në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson M. K., për shkak të kompensimit të dëmit, përkritazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, CA.nr.2547/2014 datë 2.7.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.10.2018, merr këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës KS "S.", paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, CA.nr.2547/2014 datë 2.7.2018.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, CA.nr.2547/2014 datë 2.7.2018, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e të paditurave dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë C.nr. 573/13 datë 30.5.2014, sa i përket shumave të gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material e jo material, ndërsa aktgjykimi i ankimuar është ndryshuar lidhur me kamatën dhe është gjykuar me kamat si për mjetet e depozituara në kursim mbi një vit në bankat në Kosovë, pa destinim të caktuar, e cila rrjedhë nga data 30.5.2014, si ditë e dhënies së aktgjyqimit të gjykatës së shkallës

së parë, e deri në pagesën definitive. Paragrafi i aktgjykimit të shkallës së parë që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditëses kundër të paditurave, ka mbetur i pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura KS "S." me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, ashtu që t'i ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe t'i detyrojë të paditurat që në mënyrë solidare paditëses t'ia paguajnë shumën e përgjithshme prej 2000 €, ndërsa përtej kësaj shume kërkesëpadiat të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 14.1.2008, ngasësi i automjetit A.A., duke drejtuar automjetin e markës "V VV Passat" me targë të regjistrimit ..., i siguruar te e paditura KS "S." nuk ka respektuar përparësinë e kalimit të automjetit "Opel Kadet" me targa të regjistrimit ..., të cilin e ka drejtuar A, R., i siguruar te e paditura KS "I," Prishtinë, i cili shpejtësinë e vozitjes nuk ia ka përshtatur kushteve të komunikacionit, me ç' rast nga lëshimet e dy pjesëmarrësve në komunikacion është shkaktuar fatkeqësia e komunikacionit në të cilën paditësja në cilësinë e udhëtares në automjetin e markës "V VV Passat", pëson lëndime të lehta trupore, që si pasojë i janë shkaktuar dhimbje fizike, frikë dhe ka pasur shpenzime të mjekimit.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadiat e paditëses është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit në emër të dhimbjes fizike për shumën prej 1500 €, për frikë

shumën prej 1500 € dhe për shpenzimet e shërimit në shumën prej 87,06 €, ndërsa ka vlerësuar se lidhur me kamatën, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale dhe në këtë pjesë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses pjesërisht është e bazuar. Gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimin e cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka bërë tejkalimin e kërkesëpadisë, ngase janë aprovuar shuma më të larta se shuma maksimale prej 2000 € për këtë lloje dëmi, Gjykata Supreme e Kosovës një pretendim të tillë e vlerësoi si të pabazuar, sepse në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se të paditurat nuk kanë provuar se shumat e gjykuara në dispozitivin e aktgjykimit ankimor nuk janë në harmoni me qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, përkatësisht se ato nuk janë në përputhje me kriteret si dhe me praktikën gjyqësore të krijuar gjatë zbatimit të së drejtës materiale për gjykimin e kësaj forme të kompensimit të dëmit.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material, ngase, shumat e gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga ekspertët Dr. Xh,S,- ortoped dhe Dr. N, H., në bazë të intensitetit të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar.

Vërtetimi i shpërblimit (satisfaksioni) për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD-ës duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit së cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me të mos të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditëses, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës, e duke pasur parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit paditëses nga ana e gjykatave të instancës më të ulët sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, andaj vlerësoi se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejt.

Dëmi material është gjykuar nga gjykatat e instancës më të ulët në bazë të provave konkrete për shpenzimet e krijuara për shërim të paditëses.

Gjykata e shkallës së dytë ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën, konform dispozitës ligjore nga neni 195.1 të LPK -ës, ngase kamata nga gjykata e shkallës së parë nuk është caktuar konform dispozitës ligjore nga neni 277 të LMD -ës.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SURPEME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 16.10.2018, Rev.nr.292/2018

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku